



**EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES – ECMI KOSOVO**

*Str. Rexhep Luci, No. 16/3 Prishtina, Kosovo, Tel. +381-(0) 38 224 161*

*Web: [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)*

**Konferencë e ECMI Kosovës: ‘Decentralizimi dhe Përfshirja e Shoqërisë Civile’**

Më 10 shtator 2009, ECMI Kosova ka organizuar një konferencë mbi ‘*Decentralizimin dhe Përfshirjen e Shoqërisë Civile*’. Aktiviteti u zhvillua në restorantin “Markov Konak”, në komunën e re Graçanicës. Konferenca ishte pjesë e projektit të ECMI Kosovës ‘*Përkrabja komuniteteve minoritare në procesin e decentralizimit*’, të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës. Konferenca kishte për qëllim lehtësimin e dialogut mbi procesin e decentralizimit dhe veçanërisht të rolit që mund të luajë shoqëria civile në këtë proces. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në komunat e reja, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të përfshira në ose të interesuar rreth procesit të decentralizimit.

**Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Sadri Ferati**



Konferenca u hap nga përfaqësuesi i ECMI Kosovës, z. Lars Burema, i cili u uroi mirëseardhje pjesëmarrësve dhe i dha fjalën Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Sadri Feratit, i cili mbajti një fjalë të shkurtër hyrëse mbi decentralizimin, duke nënvizuar parimet bazë të decentralizimit dhe përfitimet që ajo u ofron komuniteteve. Ministri Ferati shpjegoi se decentralizimi është transferimi i kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal dhe se ai është një proces i rëndomtë në mbarë Evropën. Për më tepër, ai siguroi pjesëmarrësit se kompetencat

shtesë sjellin burime financiare shtesë. Ai pranoi se decentralizimi është një program jashtëzakonisht kompleks dhe i vështirë dhe se Ministria në mënyrë të pashmangshme do të përballet me shumë sfida në zbatimin e tij. Megjithatë, ajo mund të jetë e suksesshme nëse e tërë shoqëria merr përgjegjësinë e vet. Në fund, Ministri Ferati theksoi rolin e rëndësishëm që ka luajtur shoqëria civile deri më tani dhe shprehu shpresën se shoqëria civile do të vazhdojë të japë mbështetjen e saj për procesin.

Pas fjalës hyrëse, Ministri Ferati shfrytëzoi pjesën e mbetur të kohës së tij për t’iu përgjigjur disa pyetjeve që kishin të bënin me mungesën e besimit të komunitetit serb, dhe me çështjet pronësore dhe të infrastrukturës. Duke iu përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve, Ministri Ferati shpjegoi se ai vetë dhe Ministria e tij kanë qenë shumë aktivë në implementim në terren me komunitetet dhe kanë qenë çdoherë të hapur për të biseduar me këdo që mund të ketë pyetje ose komente. Në të njëjtën kohë ai theksoi se ai vetë nuk mund të zgjidh të gjitha problemet e Kosovës dhe se tani për tani duhet të përqendrohet në problemet specifike që kanë të bëjnë me procesin e decentralizimit.

Decentralizimi mund të ketë sukses vetëm nëse e tërë shoqëria luan pjesën e rolit të saj në proces

*MAPL – Ministri Ferati*

**Përfaqësuesi i MAPL-së, z. Arban Abrashi**

Z. Burema falënderoi Ministrin Ferati për fjalimin e tij mjaft informues, shpjegoi shkurtimisht rendin e ditës dhe pastaj i dha fjalën përfaqësuesit të MAPL-së, z. Arban Abrashit, i cili hyri më në hollësi në lidhje me zhvillimet aktuale në procesin e decentralizimit, veçanërisht në lidhje me krijimin e Ekipeve Përgatitore Komunale (EPK-ve). Z. Abrashi shpjegoi rrugën e gjatë nëpër të cilën ka kaluar MAPL për të marrë aty ku është arritur tani. Në fillim, MAPL posedonte pak njohuri mbi dhe pak kontakte në komunat e reja. Në ditët e sotme, falë një ndihme të madhe nga shoqëria civile, MAPL-ja posedon një rrjet të gjerë

në komunat e reja, dhe mbi 300 qytetarë kanë aplikuar për t'u bërë anëtarë të EPK-ve, gjë që përbën një përparim të madh. Në të njëjtën kohë ai pranoi se në komunat e reja ende mbizotëron mungesa e informatave mbi decentralizimin dhe theksoi se MAPL, bashkë me partnerët e saj, është vazhdon të punojë në këtë çështje, dhe se UNDP ka zhvilluar një fushatë të re mediale, e cila do të fillojë së shpejti. Sa u përket EPK-ve, z. Abrashi deklaroi se deri më tani janë themeluar me sukses EPK-të në Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Kllokot / Vërboc dhe se MAPL është duke punuar shumë në themelimin e EPK-ve në Novobërdë dhe në Mitrovicën e Veriut. Aktualisht, MAPL-ja, së bashku me partnerët, sidomos USAID-in, po ndihmon dhe trajnim e EPK-ve dhe janë në hartim e sipër planit e veprimtimit për të gjitha EPK-të. Për të mbështetur EPK-të ministria ka në dispozicion një fond prej rreth €3.3 milionë, pjesë nga të cilat para mund dhe janë përdorur edhe për projekte të vogla në komunat e reja.



Z. Abrashi dha një argument specifik duke theksuar natyrën teknike të EPK-ve. Fakti se dikush është aktualisht anëtar i një EPK-je nuk do të thotë në asnjë mënyrë se ata gjithashtu do të kenë një pozitë në komunën e ardhshme. Komuna e re do të themelohet nëpërmjet zgjedhjeve lokale, dhe do të jenë zyrtarët e zgjedhur ata që do të mbajnë përgjegjësinë e formimit të qeverisë komunale. Tani për tani është përgjegjësi e EPK-ve për të rregulluar të gjitha përgatitjet teknike për të bërë të mundshëm themelimin e komunave të reja dhe për të inkurajuar komunitetin lokal që të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme. Nëse anëtarët e EPK-ve e kryejnë punën e tyre si duhet, kjo mund të rezultojë në rekomandimet për komunën e re, por kjo gjë nuk ofron garanci.

EPK-të janë ekipe teknike dhe nuk do të udhëheqin komunën; kjo do të bëhet nga zyrtarë të zgjedhur

MAPL – z. Abrashi

Duke reaguar në prezantimin e z. Abrashi pjesëmarrësit ngritën disa çështje, në lidhje me pasojat e procesit të decentralizimit për komunitetet dhe një model të hollësishëm të procesit të decentralizimit. Z. Abrashi shpjegoi se decentralizimi u ofron mundësi komuniteteve RAE, por sidoqoftë është e domosdoshme që këto komunitete të marrin një qëndrim më proaktiv ndaj procesit, dhe prandaj

lëvdoi pjesëmarrësit e komuniteteve RAE për pjesëmarrjen e tyre në konferencë. Sa i përket një plani të procesit të decentralizimit, z. Abrashi bëri të qartë se detajet e modelit të decentralizimit nëpër të cilin do të kalojë Kosova janë përcaktuar në Propozimin e Ahtisaarit, dhe se kjo është arritur pas diskutimeve intensive politike. Prandaj, aspektet teknike mbi atë se si do të duket decentralizimi janë në diskutim e sipër; në thelb është mënyra se si do të implementohet plani i decentralizimit, siç përshkruhet në Propozimin e Ahtisaarit, ai i cili është në diskutim e sipër. Ai gjithashtu pranoi se në të vërtetë ka një mungesë njohurish mbi këto hollësi, por se MAPL po punon intensivisht për të kompensuar këtë.

### Prezantimet nga përfaqësues të shoqërisë civile

Pas pauze të shkurtër për kafe morën fjalën përfaqësues të OJQ-ve që janë aktualisht aktive në mbështetjen e procesit të decentralizimit, për të shpjeguar shkurtimisht aktivitetin e tyre dhe për t'u përgjigjur pyetjeve lidhur me këto aktivitete. Përfaqësues nga Fractal, Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT), UNDP dhe ECMI Kosovës bënë nga një prezantim të shkurtër.



*Qendra për Paqe dhe Tolerancë:* Z. Saša Ilić bëri një prezantim të shkurtër në emër të CPT. Z. Ilić sqaroi se CPT-ja aktualisht është në implementim e sipër të dy projekteve për decentralizimin. Njëri projekt është financuar nga Fondacioni SOROS dhe një nga ICO. Projekti i financuar nga SOROS fokusohet në implementim në terren në rajonin e Gjilanit, ndërsa projekti i financuar nga ICO synon zhvillimin e një serie dokumentarësh mbi decentralizimin, me qëllim të dhënies së përgjigjeve pyetjeve më të zakonshme të komunitetit serb rreth decentralizimit.

*Fractal*: Z. Miloš Milovanović foli në emër të OJQ-së nga Serbia, Fractal. Ai shpjegoi se Fractal-i aktualisht po implementon një projekt që synon ngritjen e vetëdijes së komunitetit serb mbi procesin e decentralizimit. Aktivitetet e tyre fokusohen në komunat Graçanicë, Ranillug, dhe Partesh, dhe gjithashtu po planifikojnë të organizojnë një debat publik në Serbi për serbët e Kosovës të zhvendosur atje. Ata po përpiqen të vendosin kontakte me komunitetin për tu përgjigjur pyetjeve të tyre përmes aktiviteteve publike si debatet publike dhe shfaqjet teatrale.

*UNDP*: Znj. Rreze Duli foli në konferencë në emër të UNDP-së. Ajo shpjegoi se UNDP-ja është e përkushtuar për të mbështetur procesin e decentralizimit dhe ka qenë partner aktiv i MAPL-së. Së fundi UNDP ka përkrahur zhvillimin e një fushate të re informimi dhe gjithashtu së shpejti do të vejë në dispozicion grante të vogla për projekte të mbështetje të projekteve për decentralizimin, ndërtimin e paqes dhe forcimin e shoqërisë civile. Projekti ka një buxhet prej gjithsej €80 000, dhe projekt-propozimet mund të jenë me vlerë deri në €10 000.

*ECMI Kosova*: Z. Burema foli në emër të ECMI Kosovës dhe e përshkroi shkurtimisht projektin e saj, i cili ka për qëllim përfshirjen dhe informimin e pjesëtarëve të komuniteteve mbi procesin e decentralizimit dhe ofrimin e mbështetjes adekuate në ndërtimin e kapaciteteve. Në këtë kuadër, ECMI Kosova ka organizuar mbi 20 tryeza të rrumbullakëta në të gjitha komunat e reja. ECMI Kosova është çdoherë e gatshme të mbështesë propozimet relevante nga organizata apo individë në terren dhe i inkurajon njerëzit që kanë ide që të kontaktojnë organizatën.

Pas prezantimeve pjesëmarrësit shfrytëzuan rastin për të bërë pyetje dhe komente mbi mungesën e informacioneve mbi decentralizimin në mesin e komunitetit serb, rolin e mundshëm të shoqërisë civile dhe rolin e EPK-ve në zgjedhje. Sa u përket zgjedhjeve, e z. Abrashi shpjegoi se zgjedhjet janë përgjegjësi e fundit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Zyrtarëve Komunalë të Zgjedhjeve; megjithatë ai shpjegoi se EPK-të do të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e KQZ-së në organizimin e zgjedhjeve dhe në përhapjen e informatave mbi zgjedhjet.

### **Rekomandimet e grupeve punuese**

Pas pauzës së drekës pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe punuese për të identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballet procesi i decentralizimit dhe për të hartuar rekomandimet mbi decentralizimin, veçanërisht në lidhje me rolin që mund të luajë shoqëria civile në këtë proces.

#### *Sfidat kryesore të identifikuara:*

- ❖ Mungesa e informatave mbi procesin e decentralizimit në mesin e komunitetit serb: megjithëse një numër organizatash kanë qenë aktive në shpërndarjen e informatave mbi procesin e decentralizimit, shumica e pjesëtarëve të komunitetit ende kanë pothuaj aspak njohuri mbi hollësitë e këtij procesi;
- ❖ Mungesa e mirëbesimit në mes të komuniteteve: në mesin e komunitetit serb ka një mungesë themelore mirëbesimi të Qeveria e Kosovës. Për pasojë, në mesin e këtij komuniteti ka shumë skepticizëm lidhur me këtë proces;
- ❖ Mungesa e kapaciteteve të komunitetit në komunat e reja: të komuniteti serb në komunat e reja ka ekspertizë shumë të kufizuara mbi atë se si të drejtohet një komunë;
- ❖ Qëndrimi negativ i Beogradit ndaj procesit të decentralizimit: Beogradi ende ka ndikim të konsiderueshëm mbi komunitetin serb në Kosovë dhe për shkak të qëndrimit të tij negativ shumë njerëz nuk janë të gatshëm të marrin pjesë në proces, madje edhe për t'u informuar mbi procesin;
- ❖ Infrastruktura e dobët, ndjenja e pasigurisë, dhe norma e lartë e papunësisë: komunat e reja janë përballur me një periudhë neglizhence, dhe kjo fushat e përshkruara paraqiten problematike në ato zona;

- ❖ Mungesa e shërbimeve të duhura të kujdesit shëndetësor sekondar në disa nga komunat e reja: Pjesëmarrësit ishin të shqetësuar mbi atë se ku do të shkonin pjesëtarët e komunitetit për trajtime mjekësore që do të kërkonin kujdes shëndetësor sekondar;
- ❖ Gjetja e fondeve të mjaftueshme për komunat e reja për të trajtuar të gjitha problemet me të cilat përballen.

*Rekomandimet e propozuara:*

- ❖ Intensifikimi i fushatës aktuale të informimit: komuniteti serb duhet të ‘bombardohet’ me informata, me shfrytëzim të madh të mediave dhe dialogut të hapur me sa më shumë aktorë të ndryshëm që të jetë e mundur;
- ❖ Ndarja e përvojës së shoqërisë civile me komunat e reja: shoqëria civile ka vepruar aktivisht në komunitet për shumë vite dhe ka shumë përvojë për të ndarë në çfarëdo fushe, nga kultura te planifikimi strategjik e te mbledhja e fondeve. Kjo njohuri duhet të ndahet, për shembull, përmes grupeve të ekspertëve;
- ❖ Vendosja e formave të përhershëm të bashkëpunimit në mes shoqërisë civile dhe komunave të reja nëpërmjet formimit të një këshilli socio-ekonomik ose grupeve të ekspertëve;
- ❖ Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për EPK-të dhe komunat e reja;
- ❖ Shoqëria civile duhet të luajë një rol në monitorimin e komunave të reja;
- ❖ Gjithashtu u pranua se mirëbesimi i komunitetit serb te Qeveria e Kosovës mund të fitohet vetëm nëpërmjet përparimit në të gjitha sektorët, jo vetëm sa i përket decentralizimit.